



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2019

**“PËR
RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të neneve: 78, 81 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 30 Gusht 2020, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.
2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës .
3. Në rast se individ i zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit.
4. Zyrat vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës përlllogarisin:

- a. bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së pasqyruar në akt ekspertimi, e cila nuk mund të jetë më e vogël se çmimet minimale fiskale, dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi;
 - b. tatimin që duhet të paguajë individi për ta regjistruar këtë rivlerësim.
5. Në rast se individi zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, me çmimet minimale fiskale në fuqi, atëherë ky fakt shprehet në formularin që i bashkëlidhet aplikimit të tij për rivlerësim.
 6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, zyrat vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës përlllogarisin:
 - a. bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi;
 - b. tatimin që duhet të paguajë individi për ta regjistruar këtë rivlerësim.
 7. Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë, si vlerë regjistrimi, në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.
 8. Tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi është 3% e bazës së tatueshme, që përcaktohet sipas pikave 4 dhe 6 të këtij neni.
 9. Për rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferencë e vlerës, në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi.

Neni 2

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në proces legalizimi dhe regjistrimi

Subjekt i këtij ligji është edhe rivlerësimi i pasurive të paluajtshme:

1. Të individëve, të cilët janë në proces legalizimi dhe regjistrimi të pasurisë sipas legjislacionin në fuqi;

2. Të individëve të cilët disponojnë kontratë sipërmarrje ose porosie dhe që janë në proces legalizimi dhe regjistrimi të pasurisë sipas legjislacionin në fuqi.

Procedurat e rivlerësimit dhe pagesës për rastet e parashikuara në këtë nen, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave

Neni 3

Akte nënligjore

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për përcaktimin e procedurave për qëllime të zbatimit të këtij ligji si dhe përcaktimin e tarifës së kryerjes së këtij shërbimi nga ASHK-ja, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në datën 30 Gusht 2020.

KRYETARI I KUVENDIT

GRAMOZ RUÇI

D. G. Bal
T. G. Bal
15.12.19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr ____ prot.

Tiranë, më ____/____2019

Lënda: Nismë për propozimin e projektligjit: “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”

Drejtuar :

**Z. Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

K Ë T U

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën ligjore: projektligjin: “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

Bashkëlidhur, projektligji dhe relacioni shoqërues.

Me respekt,

Deputeti propozues

Arben Ahmetaj